

VENDIM
Nr. 75/2019

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT
TË STATISTIKAVE DHE ZËVENDËSIMIN E TIJ

Në mbështetje të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit dhe të pikave 6, shkronja “d”, e 7, të nenit 22, të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lirimin nga detyra e anëtarit të Këshillit të Statistikave të zotit Adrian Kamenica, përfaqësues i përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare.

II. Zëvendësimin e anëtarit të Këshillit të Statistikave të përmendur në pikën I me zonjën Oriana Arapi, përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, për pjesën e mbetur të mandatit.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.7.2019.